



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 1648 Prot.

Tiranë, më 27.09.2017

V E N D I M

Nr.196, datë 27/09/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 3, datë 23.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 3, datë 23.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë,

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr. 139, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 3, datë 23.01.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Për të rregulluar situatën në lidhje me pozicionin e punës "Sekretar i Përgjithshëm", në institucionin e prefektit të qarkut me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar. Ky proces duhet të gjejë pasqyrim edhe në përshkrimin e punës për pozicionin "Sekretar i Përgjithshëm", në institucionin e prefektit.
3. Të korrigjohen formularët e përshkrimeve të punës, në kreun XIII, me titull "Nënshkrimi", ku për Sekretarin e Përgjithshëm duhet të firmosë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që në rastin e institucionit të Prefektit është ministria e linjës, në aspektin e administrimit të shërbimit civil.
4. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, si dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masa dhe të tregojnë kujdes, për të gjitha procedurat që kanë lidhje me administrimin e shërbimit civil të cilat janë kryer në mënyrë elektronike e konkretisht, në këtë rast për formularët e përshkrimit të punës, t'i materializojnë ato edhe në formë shkresore, duke respektuar mënyrën dhe elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik", i ndryshuar; ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010, "Për dokumentin elektronik", si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 31.12.2012, të Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, "Për vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik nga institucionet publike".

Me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës, në përputhje me hierarkinë administrative, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara nga ligji për mbikëqyrjen e shërbimit civil, këto kopje duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë këndvështrim, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, duke u kujdesur që të merret mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe më tej t'i depozitojë ato në arkivin e institucionit, si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike, ashtu si është arsyetuar në raport.

5. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për punonjësit e Gjendjes Civile ***** dhe ***** duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara.

Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të anulohet aktin nr. 2119/8, datë 14.08.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin nr. 446/14, datë 12.04.2016, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, të nxjerra për punonjësen ***** me detyrë “Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë.
- Të anulohet aktin nr. 3271/7, datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin nr. 446/15, datë 12.04.2016, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, për punonjësen ***** me detyrë “Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile, rrethi Sarandë”, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë.
- Të anulohet aktin nr. 3271/6, datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin nr. 446/16, datë 12.04.2016, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, për punonjësen ***** me detyrë “Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile, rrethi Delvinë”, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë.

6. Për përmirësimin e situatës në lidhje me parregullsitë e konstatuara në rastin e ristrukturimit:

- Komisioni i ristrukturimit i ngritur me urdhrin nr. 8, datë 22.01.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin e komisionit të ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Prefektit të Qarkut Vlorë”, në zbatim të kërkesave të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kreut II, pika 18 e 19 të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të rishqyrtojë mundësinë e sistemit të punonjësve të liruar në kuadër të ristrukturimit, pasi të ketë analizuar dhe krahasuar kërkesat e posaçme të pozicioneve të krijuara nga ristrukturimi me të dhënat individuale të punonjësve, sipas orientimeve të materializuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.
- Njësia përgjegjëse të kujdeset që, në zbatim të pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për ata nëpunës që do të vendoset përsëri, lirimi nga detyra për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të vendit të punës, pasi nuk mund të emërohen në pozicionet e lira në institucion, të deklarohet e drejta që

brenda një periudhe 2-vjeçare nga data e përfundimit të marrëdhënies së punës, mund të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurën e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundje, leje lindje e arsye të tjera ligjore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është ezauruar. Në përfundim të procesit të njoftohen nëpunësit përkatës.

- 7. Institucioni i mbikëqyrur, në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, për nëpunësit *****, *****, *****, të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e parë të vitit 2016, si dhe të ndjekë procesin për të respektuar afatet edhe për 6 mujorin e dytë të këtij viti. Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për këta nëpunës, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, ashtu si parashikohet në pikën 18, të kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.*
- 8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 3, datë 23.01.2017, të Komisionerit, me Vendimin Nr. 144, datë 30.06.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 3, datë 23.01.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjëndjen e ligjshmërisë”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 04.07.2017, u paraqitën në insitucion. Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1342/2 prot., datë 30.06.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 05.07.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Komisioneri, në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit Nr. 3, datë 23.01.2017, ka kërkuar nga njësia përgjegjëse (DAP), që në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për

nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të Vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilin klasifikohet pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm në institucionin e Prefektit të Qarkut, ose pozicionin e barasvlerëshëm me të, sipas kategorive dhe klasave, të parashikuara në legjislacionin e sipërcituar.

Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 429 prot., datë 01.03.2017, “*Kërkesë për bashkëpunim*”, i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike, të sqarojë rolin e Sekretarit të Përgjithshëm, në përputhje me Vendimin e Komisionerit. Deri në momentin e verifikimit nga Departamenti i Administratës Publike nuk ka patur reagim lidhur me këtë pikë të vendimit.

- Njësia e burimeve njerëzore, në zbatim të pikës 3 të vendimit, ka korrigjuar formularët e përshkrimeve të punës, në kreun XIII, me titull “*Nënshkrimi*”, ku për Sekretarin e Përgjithshëm duhet të firmosë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që në rastin e institucionit të Prefektit është ministria e linjës dhe me shkresën nr. 1355 prot., datë 18.07.2017, “*Kërkesë për miratim të përshkrimeve të punës*”, ia ka dërguar për miratim këtij të fundit..
- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Prefektit të Qarkut Vlorë, në zbatim të pikës 4 të vendimit, me shkresën nr. 1258 prot., datë 03.07.2017, “*Kërkojme mendim për përshkrimet e pozicioneve të punës*”, ka kërkuar mendimin e Departamentit të Administratës Publike, nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç përcaktohet në pikën 19, të Vendimit Nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”. Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar.

Institucioni i mbikëqyrur, në zbatim të pikës 5 të vendimit paralajmërues, me shkresën nr. 429 prot., datë 01.03.2017, “*Kërkesë për bashkëpunim*”, ndër të tjera i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë për punonjësit e gjendjes civile. Konkretisht, referuar vendimit të Komisionerit, Njësia Përgjegjëse (DAP) duhej të konstatohej pavlefshmëri absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë për punonjësit ***** dhe *****. Deri në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike, nuk ka pasur asnjë reagim lidhur me sa më sipër.

- Në pikën 6 të vendimit, Komisioneri ka rekomanduar Komisionin e Ristrukturimit të ngritur me Urdhrin Nr. 8, datë 22.01.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin e komisionit të ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Prefektit të Qarkut Vlorë*”, që të rishqyrtojë mundësinë e sistemimit të punonjësve të liruar në kuadër të ristrukturimit, sipas orientimeve në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes dhe t’iu

njohë atyre të drejtat që rrjedhin nga neni 50 i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në përfundim të procesit të verifikimit, rezultoi se me aktin nr. 1354 prot., datë 18.07.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në shkresën nr. 1487/1/2/3/4/5/6/7 prot., datë 30.05.2016”, njësia përgjegjëse i ka njohur punonjësve të larguar për shkak të ristrukturimit të drejtën që brenda një periudhe 2-vjeçare nga data e përfundimit të marrëdhënies së punës, të mund të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurën e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, ose të emërohen në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e tyre në pozicione pune të shërbimit civil. Pavarësisht këtij fakti, njësia përgjegjëse duhet të bëjë kujdes që në të ardhmen kjo e drejtë t’iu njihet punonjësve në aktet individuale të largimit për shkak të ristrukturimit..

- Në zbatim të pikës 7 të Vendimit Nr. 3, datë 23.01.2017, njësia e burimeve njerëzore në respektim të procedurave të parashikuara në Vendimin Nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar kishte përfunduar procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësit ***** dhe ***** për 6-mujorin e parë të vitit 2016. Gjithashtu ishin të administruara në dosjet personale të nëpunësve dhe vlerësimet e punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2016, në zbatim të rëkomandimeve në Raportin Përfundimtar të Mbikëqyrjes.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 3, datë 23.01.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmëruar. Aktualisht, pritët reagimi i Departamentit të Administratës Publike në lidhje me:

1. Rregullimin e situatës në lidhje me pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit të qarkut me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil (pika 2 e vendimit).
2. Për punonjësit e Gjendjes Civile ***** dhe ***** duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit (pika 5 e vendimit).

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 3, datë 23.01.2017, në institucionin e Prefekturës të Qarkut Vlorë.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 3, datë 23.01.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
3. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2 dhe 5 të dispozitivit të Vendimit Nr. 3, datë 23.01.2017, për të cilat kërkohet reagimi i Njësisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA